




REPUBLIKA E KOSOVËS AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Titulli Dok. Nr. Datë	DPK 01/23.07/13
Numri i Dok. Irbash Mënyrja	2 faze 31.07.13



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë **25.07.2013**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-1154/13 për z.Bajram Ukaj – Dekan i Fakultetit Juridik në Universitetin e Prishtinës, lidhur me procesin e përzgjedhjes së Asistentëve të ri në këtë fakultet, sepse nuk ka pasur prova të mjaftueshme që flasin për situatë të konflikt të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-1154-13, për Zyrtarin e lartë, z. Bajram Ukaj – Dekan i Fakultetit Juridik në Universitetin e Prishtinës, lidhur me procesin e përzgjedhjes së Asistentëve të ri në këtë fakultet, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-1154/13, të hetuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari i lartë, z. Ukaj së pari i është bërë një kërkesë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (Z.D.DPK-01-1370/13), me të cilën janë kërkuar dokumentet relevante që e pasqyrojnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për Asistentë të ri në Fakultetin Juridik.

Pas kësaj shkrese, Zyrtari i lartë, ztr. Ukaj, është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë, me ç'rast ka sjellur edhe dokumentacionet e kërkuara dhe me të është biseduar për procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për Asistentë.

Zyrtari i lartë, z.Ukaj ka përshkruar procesin e zgjedhjes dhe emrimit të Asistentëve të rinj, për të cilët ka deklaruar se ai si Dekan i fakulteti Juridik nuk ka kompetenca ekzekutive, por sipas Statutit të Universitetit të Prishtinës, kjo procedurë rrjedh kështu; Katedra i propozon kandidatët në Këshillin e Fakultetit. Këshilli i Fakulteti pastaj bënë miratimin e kërkeses nga Katedra dhe ato propozime i përcjell në Senatin e Universiteti te Komisioni për çështje mësimore. Ky

Komision pasi i shqyrton ato, i përcjell për Senatin e Universiteti i cili edhe i voton dhe i aprovon, ndërsa Rektori i Univeriteti (si punëdhënës) i fuqizon ato me Vendim.

Ndërkohë, pas kërkesës tonë, ztr. Ukaj na ka dërguar edhe procesverbalin e mbledhjes së Këshillit të Fakulteti Juridik (anëtar i së cilit është edhe ai në cilësinë e Dekanit) të datës 31.01.2013.

Në këtë procesverbal shihet se pikërisht pas propozimit që Katedra ndërkombetare i ka propozuar tre kandidatët për Asistentë, ztr. Ukaj ka dal nga mbledhja duke apstenuar në votim. Krejt kjo për të shmangur një situatë të konfliktit të interesit që ishte i mundshëm meqë në listën e të propozuarve ishte edhe kandidatja Valëza Ukaj, e bija e Dekanit, Bajram Ukaj.

Këshilli unanimisht ka votuar për tre kandidatët e propozuar, e të cilët pastaj u janë nënshtruar procedurave tjera të përshkruara më lartë.

Andaj , duke u bazuar në faktet dhe gjendjen reale, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

